



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 134/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Vitomir Đusić, lidhur me tërheqjen nga lista e kandidatëve të certifikuar për Anëtar të Kuvendit të Komunës së Zubin Potokut, nga subjekti politik Nova Snaga, për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i palejueshëm apeli i Vitomir Đusić, kandidat për Anëtar të Kuvendit të Komunës së Zubin Potokut, nga subjekti politik Nova Snaga.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 01.10.2013, nga zyra e OSBE-së në Prishtinë, ka pranuar një apel që është parashtruar nga Vitomir Đusić, në cilësinë e kandidatit për anëtarë të Kuvendit të Komunës në Zubin Potok, nga subjekti politik Nova Snaga, më të cilin apel kërkon që të tërhiqet nga e lista kandidatëve të certifikuar të subjektit politik të lartpërmendur, me arsyetimin se në këtë listë e kanë regjistruar pa pëlqimin e tij.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, dhe gjeti se:

apeli është i palejuar

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve të certifikuar nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) konkretisht me nenin 28.1, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013. Parashtruesi i apelit në PZAP nuk e ka

shfrytëzuar të drejtën që kishte deri me datë 17.09.2013, për të parashtruar kërkesës për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. PZAP-i konstatoi se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP, për pa i shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike që përcaktohen sipas LZP-së, gjë që nuk është e lejuar, prandaj PZAP-i, gjeti se apeli është i palejuar dhe në kuptim të nenit 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 134/2013 më datën 03.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*